



REPUBLIKA E KOSOVË

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E -VIII-TË ME RADHË E -IV- E RREGULLT E KUVENDIT TË**  
**KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 25 QERSHOR 2020**

*Mbledhja është mbajtur në objektin e Shkollës së Mesme Gjimnazi "Eqrem Çabej" në Vushtrri, duke filluar në orën 10:20.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë: Abdullah Vojvoda, Ali Januzi, Agron Perçuku, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Fatmire Saraçi, Ermal Lahu, Fakte Dushi, Faton Shabani, Fitim Halili, Gresa Muli, Gentiana Rama, Habibe Gërshaliu, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Hajriz Mustafa, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Miljan Bojković, Mejreme Ismajli, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Nurtene Çerkezi-Gyshinca, Sajdie Bajgora, Selim Rrustemi, Shkëlzen Feka, Safet Idrizi, Melihate Basholli-Latifi, Suzana Syla Teuta, Aruçi Shartari, Shpëtim Zhegrova dhe Ymer Haradinaj.

**Munguan:** Hysni Gërguri, Agim Bregaj, dhe Basri Menxhiqi.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe nënkryetari i komunës z. Besim Muzaqi, drejtorët e drejtorive komunale dhe zyrtar kompetent komunal.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë të pranishëm 32 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-në emër të grupit kuvendar të PDK-së, propozoi që si pikë e parë e rendit të ditës të inkorporohet deklarata e përbashkët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për mbrojtjen e vlerave të luftës të UÇK-së.

*Pas shqyrtimit Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë me vota "unanime" aprovoi këtë:*

**R E N D I T E**

1. Shqyrtimi i deklaratës për mbështetjen e vlerave të luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja urgjente e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më 26 mars 2020;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 28 maj 2020;

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2021 – 2023;
5. Shqyrtimi i Draft-rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë);
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e panelit përzgjedhës, për zgjedhjen e anëtarëve të komiteteve konsultative;
7. Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të objekteve;
8. Të ndryshme.
  - a) Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja urgjentet e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më 10 qershor 2020;
  - b) Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

1. Shqyrtimi i deklaratës për mbështetjen e vlerave të luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-në emër të grupit kuvendar të PDK-së, para kuvendit lexoi deklaratën për mbrojtjen e vlerave të luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ai kërkoi nga anëtarët e kuvendit që këtë deklaratë të mbështesin në mënyrë unanime.

*Pas diskutimit të anëtarit të kuvendit z. Ilmi Azemi, kuvendi me vota “unanime” vendosi me sa vijon:*

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 25 qershor 2020, duke marrë për bazë aktakuzat e ngritura nga dhomat e specializuara të Gjykatës Speciale, ndaj udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pas konsultimeve mes grupeve kuvendare në mënyrë unanime miraton këtë:

#### Deklaratë

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, me qëllim të mbrojtjes së vlerave dhe luftën e pastër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, publikisht e mbështesim këtë deklaratë të përbashkët dhe besojmë në pastërtinë e luftës së UÇK-së.

Lidhur me këtë, ne Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

- Rikujtojmë , ballëhapur e faqebardhë se lufta e popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi ka qenë një kërkesë e kamotshëm e popullit shqiptarë.
- Konsiderojmë se kauza e popullit shqiptar të Kosovës për çlirim e pavarësi ka qenë e drejtë, kurse UÇK-ja është jo vetëm pika më e lartë e përpjekjeve historike të popullit të Kosovës për liri e vetëvendosje, por edhe kapitulli më i lavdishëm i historisë sonë kombëtare.
- Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka zhvilluar luftë të pastër dhe të drejtë në përputhje të plotë me të gjitha normat, konventat, ligjet dhe standardet ndërkombëtare.
- Shteti serb ka ushtruar gjenocid ndaj popullsisë shqiptare, ka vrarë e masakruar civilë të pafajshëm vetëm se ishin shqiptarë. Përfshirë edhe masakrën e 2 Majit në Studime dhe masakrën e 22 Majit në Vushtrri që kanë mbetur ende pa u ndëshkuar.
- Shprehim solidaritetin tonë me udhëheqësit dhe ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës veçanërisht Presidentin Hashim Thaçi dhe Kadri Veselin, të cilëve iu është

ngritur aktakuzë për krime lufte. Ne besojmë fuqishëm në pafajësinë e tyre, dhe pohojmë se lufta e tyre ka qenë e drejtë dhe e pastër.

Shprehim mirënjohjen tonë për kontributin e secilit pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për çlirimin e Kosovës.

U jemi përjetësisht mirënjohës.

Vushtrri,  
25 Qershor 2020

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit**-tha se pajtohet plotësisht me deklaratën e propozuar më lartë, por ceku se kjo deklaratë duhet të përgjithësohet në kontekstin e pastërtisë së luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke mos u përmendura emra të veçantë në këtë deklaratë.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-tha se pa dashur që kjo çështje të politizohet, vlerëson se është shqetësues deklarimi i përfaqësueses së Lëvizjes Vetëvendosje. Pastaj shtoi se është skajshmërisht e ulët dhe e papranueshme të dilet kundër kësaj deklarate pavarësisht divergjencave politike që janë normale në politikë dhe në kuvend. Në këtë relacion ai shpërfaqë se kjo deklaratë po miratohet pikërisht kundër aktakuzave ndaj Presidentit z.Hashim Thaqi dhe Kryetarit të PDK-së z. Kadri Veseli, të cilët janë kreatorët e luftës dhe figura të dalluara kombëtare. Andaj ai i falënderoi të gjithë anëtarët e kuvendit të cilët në mënyrë unanime e votuan këtë deklaratë.

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit**-përsëriti se e mbështet plotësisht pastërtinë e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pasi që edhe ajo është vajzë e një veterani të UÇK-së. Ajo vlerësoi se gabimi ishte tek kryesuesi i kuvendit i cili ishte dashur që pas prezantimit të kësaj deklarate nga grupi kuvendar i PDK-së të hap diskutimi dhe që tu jepet mundësia anëtarëve të kuvendit që ta plotësojnë këtë deklaratë.

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja urgjente e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më 26 mars 2020;

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit në mënyrë "unanime" aprovoi procesverbalin nga mbledhja urgjente e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më 26 mars 2020.*

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 28 maj 2020;

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, mbajtur më 28 maj 2020.*

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2021 – 2023;

**Abit Abiti, ZKF**- paraqiti sqarime hyrëse lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2021 – 2023, duke shpalosur hapat e planifikimit të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2021 konform instruksioneve të dhëna nga Ministria e Financave. Pastaj ai sqaroi se modifikimet e bërë në këtë

dokument komunal kanë të bëjnë me dërgimin e projekteve nga ana e drejtorive komunale. Ndryshime i referohen faqeve nga 26 në faqen 31 që lidhen me planifikimin e projekteve.

**Pas sqarimeve të bëra nga zyrtarët kryesor financiarë, kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim aprovohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2021-2023 e Komunës së Vushtrrisë, konform Qarkores Buxhetore 2021/01, e lëshuar nga Ministria e Financave, me të cilën caktohen kufijtë buxhetor të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2021-2023.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Korniza Afatmesme Buxhetore 2021-2023 e Komunës së Vushtrrisë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit.
5. Shqyrtimi i Draft-rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë);

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoi Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.**

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për themelimin e panelit përzgjedhës, për zgjedhjen e anëtarëve të komiteteve konsultative;

**Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të LDK-së, propozoi për anëtar të panelit përzgjedhës, për zgjedhjen e anëtarëve të komiteteve konsultative z.Agron Përçukun.

**Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të LVV-së, propozoi z.Faton Shabani për anëtar të këtij paneli.

**Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të PDK-së, propozoi z.Kushtrim Hysenin për anëtar të këtij paneli.

**Mehdi Bejtullahu, anëtar i kuvendit-** kërkoi që të respektohet barazia gjinore sa i përket përbërjes së këtij paneli.

**Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës-** tha se i mbetet ekzekutivit komunal dhe shoqërisë civile që kur ti dërgojnë emrat për këtë panel të respekton barazinë gjinore.

**Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit-** tha i vjen mirë që po kuptohet drejt barazia gjinore, ashtu që ajo duhet sensibilizuar jo vetëm nga gratë, por edhe nga burrat. Në kontekst të themelimit të këtij komisioni ajo apeloi tek kryesuesi i kuvendit se një komision me një përbërje të tillë nuk duhet lejuar.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 25 vota “për” 2 vota “kundër” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim formohet paneli përzgjedhës për anëtarësim në komitetet konsultative të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë në këtë përbërje:

- 1.1 Kushtrim Hyseni, anëtar i kuvendit;
- 1.2 Faton Shabani, anëtar i kuvendit;
- 1.3 Agron Përçuku, anëtar i kuvendit;
- 1.4 Remzije Zekolli, anëtare e ekzekutivit dhe
- 1.5 Isak Hyseni, nga shoqëria civile.

2. Paneli përzgjedhës i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të ketë për obligim intervistimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve, si dhe do t'i propozojë kuvendit listën me kandidatë për anëtarësim në komitetet konsultative.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: paneli i cekur në pikën 1 të këtij vendimi dhe Sekretaria e kuvendit.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

7. Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të objekteve:

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-ceku Komuna e Vushtrrisë sidomos qytetit karakterizohet me një reliefë bujqësorë dhe që ka edhe prona në masën e komasacionit. Duke ju referuar planit urban, ku shumë prona që janë në komasacion në to është lejuar ndërtimi por që shndërrimi i këtyre pronave në toka ndërtimore zyrtarisht nuk është bërë. Andaj lidhur me këto ai pyeti Drejtorinë e Urbanizimit se si po veprojnë kur për bëjnë legalizimin e objekteve pa leje që janë ndërtuar para datës 5 shtator 2018 të cilat kuvendi i komunës me Planin Zhvillimor Komunal i ka kthyer në toka ndërtimore, këtu bëhet fjalë sidomos për rastin e 150 metrave majtas dhe djathtas nga maxhistrailja. Pastaj në kuadër të PZHK-së, ku një pjesë e pronave është kthyer në tokë ndërtimore e në ato prona ka ndërtime dhe këto a po vendosen në listën e pritjes ashtu siç i parasheh ligji, apo janë duke i trajtuar objektet të cilat janë të ndërtuara para datës 5 shtator 2018 në pronat që në kadastër evidentohen si prona në komasacion, apo vendosen në listën e pritjes apo iu japin lejen e legalizimit. Në fund tha se është interesant të analizohet se si është mundur që të mos legalizohet një objekt. ku lejohet leja e ndërtimit e nuk lejohet leja e legalizimit.

**Gresa Muli, anëtare e kuvendit**-shprehu shqetësimin e saj për mungesën e drejtorëve të drejtorive komunale në mbledhjet e kuvendit sidomos kur bëhet fjalë për pika të rëndësishme që janë në rend të ditës, kërkoi që kjo të mos përsëritet në të ardhmen.

8. Të ndryshme.

a). Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja urgjentet e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më 10 qershor 2020:

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit në mënyrë "unanime" aprovoi procesverbalin nga mbledhja urgjente e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më 10 qershor 2020.*

b). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit;

**Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit**-pyeti se përse kryetari i komunës dhe drejtorët e drejtorive komunale që vijën nga radhët e LDK-së, nuk janë të pranishëm në mbledhjen e kuvendit. Ai shprehu shqetësimin e tij për këto mungesa të paarsyeshme që ndikojnë direkt negativisht në shqyrtimin dhe përgjigjet e tyre për çështjet që janë objekt i rendit të ditës në mbledhjen e kuvendit. **Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit**-shprehu shqetësimin e saj dhe të gjithë mësimdhënësve për realizimin e pagesave të tyre sipas obligimeve që dalin nga kontrata kolektive, kjo për faktin se është dëmtuar buxheti i komunës nga këto obligime për komunën në njërin anë e në anën tjetër është dëmtuar edhe buxheti i mësimdhënësve por në këtë rast jo vetëm buxheti i mësimdhënësve por është cenuar edhe dinjiteti i tyre. Shqetësimi i saj dhe kolegëve të saj është se pasi janë marrë ato mjete nga mësimdhënësit ka ardhur një shkresë nëpër shkollë që disa mësimdhënës duhet ti kthejnë një pjesë të atyre mjeteve sepse llogaritja është bërë gabim. Në këtë kontekst ajo vlerësoi se nëse kalkulim është bërë gabim atëherë pse janë realizuar kërkesat e mësimdhënësve dhe në anën tjetër që është edhe më shqetësuese për të cilën kërkon përgjigje nga Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Buxhetit është se mësimdhënësit ato mjetet financiare i kanë kthyer në keshë dhe në këtë rast asnjë dëshmi tjetër nuk kanë marrë që i kanë dorëzuar ato të holla përveç sa kanë nënshkruar një dokument i cili është vulosur me vulën e shkollës, andaj për këtë ajo kërkoi përgjigje që të sigurohet ajo, anëtarët e kuvendit dhe të gjithë qytetarët se këto mjetet financiare janë kthyer në xhirollogarinë e komunës pasi që ajo mendon se kthimi i këtyre mjeteve është bërë në mënyrë të jashtëligjshme.

**Afrim Namani, drejtor i DA-së-sqaroi** se pas përfundimit të procedurës përbarimore janë derdhur mjetet financiare në llogarinë e mësimdhënësve dhe pas kësaj janë konstatuar disa gabime. Gabimet për disa mësimdhënës konsistojnë në atë se nuk është bërë llogaritja e pagës bazë siç e parashih marrëveshja kolektive por e pagës bruto. Në këtë kontekst në marrëveshje me mësimdhënësit dhe përfaqësuesit ligjor të tyre jemi dakorduar që ato mjete që janë llogaritur dhe që iu janë dhënë mësimdhënësve që të vërtetohet kjo çështje është caktuar nga shkollë që një person zyrtar ti pranojë ato mjete të grumbulluara ashtu që të njëjtat të kthehen tek përbaruesi e që ky i fundit këto mjet do ti kthejë në thesarin e komunës. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Financave por edhe me Zyrën Ligjore të Komunës është konstatuar se kjo rrugë e kthimit të këtyre mjeteve është krejtësisht ligjore.

**Melihate Basholli-Latifi, anëtare e kuvendit**-pyeti se pas përfundimit të të gjitha procedurave të kthimit të mjeteve financiare në thesarin e komunës, a ka ndonjë modalitet që mësimdhënësi të pajiset me një dokument për dorëzim-pranimin e atyre mjeteve, krejt kjo më për ti hequr dilemat dhe për të bërë transparent edhe para qytetarëve këto transaksione.

**Afrim Namani, drejtor i DA-së**-tha se kthimit i këtyre mjeteve do të bëhet shumë shpejt në thesarin e komunës, në formë ligjore dhe pas përfundimit të këtyre procedurave përbaruesi privat zyrtarisht do ta njoftoj komunën për derdhjen e mjeteve financiare në xhirollogarinë e komunës, për këtë me kohë do të njoftohen edhe mësimdhënësit.


**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit**-tha se për llogaritja e gabuar e mjeteve financiare për mësimdhënësit nga përmbusha e obligimeve që dalin nga marrëveshja kolektive, janë si rezultat i gabimeve në vendimet e Inspektoratit të Punës, mirëpo ajo që e bënë të lumtur atë është fakti se të gjithë mësimdhënësit anëtar të sindikatës kanë shprehur gatishmërinë që mjetet që nuk ju takojnë të i'a kthejnë komunës dhe kështu edhe është vepruar në bashkëpunim me përfaqësuesit e tyre ligjor. Tutje ai shtoi se kishte me qenë mirë që të gjendet rruga ligjore që komuna ti përmbushë obligimet ndaj mësimdhënësve që dalin nga dokumentet juridikisht të obligueshme, ashtu që

mësimdhënësit pas një kohe mos të detyrohen që përsëri ta ndjekin rrugën gjyqësore për realizimin e të drejtave të tyre. Pastaj shtoi se është lajmë i mirë që në Kornizën Afatmesme Buxhetore e cila më herët u aprovua, janë planifikuar mjetet për realizimin e pagave jubilarë për mësimdhënësit në vitin e ardhshëm, por ceku se kishte me qenë mirë në kuadër të kësaj të gjendet rruga ligjore për realizimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe atyre për shujtat. Në kontekst të kësaj ceku se mësimdhënësit tashmë e dinë se sa herë të ushtrojnë padi do të fitojnë kontestin dhe atë do të ushtrojnë këto të drejta, por e keqja e krejt kësaj është se po dëmtohet buxheti i komunës por edhe i mësimdhënësve duke u rritur shpenzimet gjyqësore për komunën dhe shpenzimet e përfaqësuesve ligjor dhe përmbartimore për mësimdhënësit. Në fund ceku se duhet të shteren të gjitha mjetet ligjore për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje duke u shmangur rruga gjyqësore, kjo do të mund të bëhet nga komuna në bashkëpunim me Qeverinë dhe Kuvendi e Kosovës dhe Sindikatën e Arsimit.

**Afrim Namani, drejtor i DA-së**-njoftoi se kur të bëhet planifikimi i buxhetit për vitin e ardhshme do të planifikohen edhe shpenzimet që dalin nga marrëveshja kolektive e arsimit. Propozimi nga ana e Drejtorisë së Arsimit do të bëhet më kohë, por se a do të pranohet nga Ministria e Financave kjo mbetet të shihet.

**Mbledhja përfundoi në ora 11:05.**


Bastri Duraku



Procesmbajtës



Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit